



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2014 prot.

Shkodër, më 31.01. 2025

**VENDIM
Nr. 9 datë 30.01.2025**

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z.MITER DJEGESINA DHE Z. FEHMI REXHA
BANESA E TË CILEVE ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 30.01.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin Nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”; Ligjin Nr.68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; VKM-në Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKM Nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; VKB Nr. 76 datë 19.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të viti 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës” si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **z. Miter Djegesina** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë (sipas certifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Miter Djegesina** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 346 343 (treqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e dyzet e tre) lekë dhe për dëmet në orendi prej 390 800 (treqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind) lekësh , sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Miter Djegesina**.
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **z. Fehmi Rexha** (3 anëtarë familje), në vlerën prej 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë (sipas certifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri .

4. Për familjen e z. **Fehmi Rexha** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 408 182 (katëqind e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë dhe për dëmet në orendi prej 266 400 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekësh , sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Fehmi Rexha**.

5. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin **AB141**“ Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025 të miratuar me VKB Nr 76 datë 19.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, në programin **AB141, Q2 O1 A4** “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 160 000 (njëqind e gjashtëdhjetëmijë) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.

6.Për familjen e Z. Miter Djegesina dhe z. Fehmi Rexha kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 pika 3.1/a “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile “, sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 377 262,5 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy presje pesë) lekë dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën 328 600 (treqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind) lekë pas akordimit të fondeve nga Ministria e Mbrojtjes, Agjencisë Kombetare të Mbrojtjes Civile.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 37 vota

Vota Pro	37
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	31.01.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj

